

VENDIM

Nr. 475, datë 8.6.2017

PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË NATO-S NË LETONI¹

(Ndryshuar me VKM nr.126, datë 7.3.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të një toge EOD, të përbërë nga 21 (njëzet e një) ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni.
2. Misioni i personelit të togës EOD është kryerja e detyrave në mbështetje të grup-batalionit të Kanadasë.
3. Togës EOD, që merr pjesë në këtë mision, nuk i lejohe të angazhohet për asgjësim municionesh CBRN, ndërtim fushash të minuara (FM) dhe detyra trajnimi për të tjerët.
4. Venddislokimi i togës EOD të jetë në Riga, Letoni.
5. *Kobëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2019, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit, për çdo togë, të jetë 6 (gjashhtë) muaj, së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me togën e radhës.*
6. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:
 - a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
 - b) sigurimin e jetës;
 - c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;
 - ç) mbështetje shëndetësore;
 - d) ushqim;
 - dh) akomodim;
 - e) ujë;
 - ë) lavanderi;
 - f) shërbim telefonik, interneti, konfigurim PC në rrjetin “NATO Sekret” dhe shërbime postare;
 - g) materiale konsumi për aparaturë;
 - gj) mirëmbajtje pajisjesh dhe aparaturash;
 - h) transport;
 - i) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
 - j) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;
 - k) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.
7. Transporti i personelit që do të marrë pjesë në misionin në Letoni ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji,

¹ VKM nr.475, datë 8.6.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.133, 19 qershor 2017.
VKM nr.126, datë 7.3.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.33, 12 mars 2018.

lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, ku pala /palët tjetër/e tjera të marrë/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

8. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

9. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama